



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pratimet e Komiteteve Me Dama 03-08-2026			
Nr. Komitete	Nr. Komitete	Nr. Komitete	Vlera
07	110/05	767	767



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, neni 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenin 17, pika 1.2 dhe nenin 22, pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, si dhe në nenin 14, nënparagrafin 1.5 të Rregullores Nr. 02/2021 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 30.07.2027 miraton këtë:

V E N D I M

për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2027

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2027.

Neni 2

Propozimi në diskutim publik i projekt planit të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2027 do të jepet në diskutim publik deri me: **31.08.2026** Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshim apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik, gjithashtu në formën të shkruar munde të paraqiten gjate kohëzgjatjes së dëgjimit publik ne zyrën e sekretarisë së Kuvendit Komunal të Vitisë ndërtesa e komunës (ish tatimi në pronë), zyra nr. 2 si dhe në forme elektronike munde të dërgohen ne emalin adresën fatlum.demiri@rks-gov.net, dokumenti gjendet në fep faqen e komunës së Vitisë, kk.rks-gov.net/viti.

Neni 3

Debati publik do të mbahet me datën **03.09.2026**, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2027.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe Zyra e Sekretarisë së Kuvendit.

Neni 7

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr.08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27, dhjetor 2024), nenin 5, paragrafi 1, si dhe nenin 8, lidhur me nenin 9, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare, në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Zyrës së Sekretarisë;

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI